



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 511 Prot.

Tiranë, më 21.01. 2025

U R D H Ë R

Nr. 35, Datë 21.01. 2025

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 36, DATË 24.1.2023 “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË
REVISTAVE SHKENCORE QË BOTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 60 dhe 79, të ligjit 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 3 të kreut V, të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar, të vendimit nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, të ndryshuar dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Në urdhrin nr. 36, datë 24.01.2023 “Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë”, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

a) Pikat 1, 3, 4 dhe 5 të nenit 7 ndryshojnë si vijon:

“1. Institucionet kërkimore shkencore ngarkojnë aplikimin në platformën e-Albania për përfshirjen e revistës/ave shkencore në regjistër.

...

3. Aplikimi kryhet në platformën e-Albania dhe përmban:

a) Formularin e aplikimit, i cili plotësohet në platformën e-Albania, me elementët e mëposhtëm:

...

b) Dokumentacioni provues sipas elementëve të plotësuar në formular.

...

4. Regjistrimi fillestar i revistave të botuara nga institucionet kërkimore shkencore, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit drejtuar AKKSHI, nëpërmjet platformës e-Albania.

5. Aplikimi shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimi i Senatit të IAL, apo Këshillit Shkencor të institucionit kërkimor për miratimin e formës së revistës dhe periodicitetit, ngarkohen si kopje e skanuar me originalin.

b) Akti i hapjes së revistës ose numri më i vjetër i revistës që disponon institucioni

c) Akti i indeksimit të revistës.

d) Forma e revistës (design) që do të regjistrohet.”.

b) Pas pikës 1, të kreut III, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Procedura e aplikimit sipas këtij udhëzimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS).

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga AKKSHI, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS), trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohet zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet që kryejnë veprimtari shkencore në Republikën e Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ



Konceptoi:	A. Manja M. Ramçi R. Hoxha	  
Miratoi:	B. Biçoku V. Koçi M. Bimo Sh. Allkaj Xh. Bixheku A. Balliu R. Alla M. Muça G. Janaqi	        
Miratoi:	J. Çollaku	
Konfirmoi:	E. Tola	